REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 12/17
Datë/Datum. 31.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"KK Prishtine".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr. 12/17.**
Nga:	Zenel Hisenaj – Ekspert Teknik Visar Bibaj - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile - E Kiosk"**, me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**"PBC" me seli në Prishtine**		
Datë	**31.01.2017**		

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile - E Kiosk"** me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"KK Prizren".**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		20.01.2017		**24.01.2017**		**31.01.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 14.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **12/17,** e parashtruar nga OE "**PBC"- shpk** me seli në Prishtine, lidhur me aktivitetin të prokurimit "**Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile - E Kiosk"** me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - **Komuna Prishtine.**

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Prishtine .**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "PBC" me seli në Prishtine.

Pikat e Ankesës nga OE **"PBC"** nga **Prishtina**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*
Supozojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur:

- Neni 1 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 7 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 28 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 53 i ligjit për Prokurim Publik
- Neni 108/A i ligjit për Prokurim Publik
- Paragrafin e 8'të të nenit 118 të ligjit për Prokurim Publik

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1 te ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik te republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe paragrafin e 4'te te nenit 18

te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:

a. Autoriteti Kontaktues udhëhequr këtë procedure jashtë etikes profesionale, jashtë integritetit profesional dhe ka shpërdorur rrënjësisht përgjegjësitë qe ka ndaj fondeve publike dhe operatoreve ekonomik.
   Provë: sjellje irracionale dhe këmbëngulëse gjate gjithë procedurës se prokurimit shih korrespodencat.

2. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 te ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik te republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe paragrafin e 4'te te nenit 18 te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:
   a. Autoriteti Kontaktues nuk i ka trajtuar barabaresisht te gjithë operatoret ekonomik dhe ka ekzekutuar aspekte te prokurimit qe kane reduktuar ndjeshëm konkurrencën ndërmjet operatoreve ekonomik.
      Provë: Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigjet (Informacionet shtese) te domosdoshme për te definuar qarte subjektin e kontratës dhe fushëveprimin e angazhimit te operatoreve ekonomik. Kjo ngjalle dyshime serioze se dikujt nga Operatoret Ekonomik i janë dhënë informata te plota ne mënyrë jo zyrtare, ndërsa neve, përkundër qe te njëjtat i kemi kërkuar dhjetëra here nuk na janë dhënë.

3. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 te ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik te republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe paragrafin e 4'te te nenit 18 te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:
   a. Autoriteti Kontaktues nuk i ka përpiluar specifikimet teknike ne atë mënyrë qe ato te jene ne përputhje me qëllimin e prokurimit dhe te drejtuara drejt sigurimit te qasjes sa me te mire për te gjithë operatoret e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.
      Provë: ka kërkuar funksione te padefinuara ne shkallen minimale te realizimit, ka kërkuar produkte dhe pajisje qe iu përgjigjen vetëm një prodhuesve specifik dhe i diskriminojnë te tjerët – shih kërkesën për informacione shtese nga ana jone.

4. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 53 te ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik te republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe paragrafin e 4'te te nenit 18 te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:
   a. Autoriteti Kontaktues nuk na ka dhënë informacione plotësuese, dhe pse te njëjtat i kemi kërkuar dhjetëra here, As nuk ka konstatuar se informacione te tilla janë te panevojshme, siç përkufizohet ne udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik.
      Provë: shih kërkesën për informacione shtese dhe kërkesën për RI-Shqyrtim te Vendimit, Për ato qe janë me ngjyre te kuqe nuk kemi pranuar përgjigje.

5. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 108/A te ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik te republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe paragrafin e 4'te te nenit 18 te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:
   a. Autoriteti Kontaktues nuk e ka marre fare parasysh kërkesën për RI-Shqyrtim te vendimit te dërguar nga ana jone dy(2) here, as nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit e as nuk i ka shqyrtuar ato e as nuk na ka kthyer përgjigje.
   Provë: shi shkresat tona (dt. 04.01.2017 dhe 08.01.2017) dhe konfirmimin e pranimit te tyre nga Autoriteti Kontraktues (05.01.2017 dhe 10.01.2017)
6. Konsiderojmë se Autoriteti kontraktues ka shkelur paragrafin e 8 te nenit 118 te ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik te republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe paragrafin e 4'te te nenit 18 te udhëzuesit Operativ për prokurim Publik, sepse:
   a. Autoriteti Kontaktues nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-se numër 360/16, pasi qe, përkundër se atu thuhet qe te respektohet ekspertiza e ekspertëve shqyrtues, e ne ekspertize thuhet te mos kërkohet mostra e e-kioskës – prezantimi i saje, ndërsa autoriteti kontraktues ka ne dosjen e tenderit e ka kërkuar atë, ne mënyrë decidive.

Prandaj, bazuar ne këto qe u tha me sipër, fuqishëm konstatojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshti me dispozitat ligjore, te theksuar me sipër dhe kërkojmë qe ky proces i prokurimit te RITENDEROHET dhe te riniset një procedure qe garanton barazi dhe integritet ndërmjet operatoreve ekonomik.

Demi Material

Pamundësia e pjesëmarrjes ne këtë procedure prokurimi, përkatësisht implementimit potencial te kësaj kontrate, kompanisë sonë i pamundësohet profiti monetar ne vlere prej hiç me pak se 3,800 EUR.

Propozimi

Te kthehet lënda ne Ri Tenderim

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	13.09.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	10.01.2017
Data e vazhdimit te afatit:	29.09.2016
Data e vazhdimit te afatit.....:	28.12.2016
Data e hapjes së ofertave	10.01.2017

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

   Dëshmitë tjera lidhur me kërkesat e pranueshme risë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

   Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshme risë janë me se vijon:
2. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit- **Vërtimin nga Gjykata** Ekonomike-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës
3. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] - Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi (duhet dorëzuar së bashku me tenderin).
2. Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike-për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës- për te propozuarin për kontrate.
3. Vërtetimin nga ATK-ja-për tenderuesin e propozuar për dhënieje të kontratës- për te propozuarin për kontrate.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesat:

1. Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve
2. Certifikatë e numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e certifikatës se regjistrimit të biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara
2. Kopja e certifikatës se numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N/A

Kërkesa

1. Qarkullimi për furnizime të ngjashme në tre vitet e fundit-2013,2014,2015 - minimum 75,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Raportin-tet bankare apo konfirmimin nga një apo me shume banka për qarkullimin e kërkuar

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional.

Kërkesa:

1. OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar furnizime – shërbime te ngjashme ne tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015).
2. OE duhet të jetë i autorizuar për shitje dhe instalim të pajisjeve që oferton.
3. OE duhet të ofroj certifikatë ose deklarate te cilësisë se produkteve qe oferton
4. Stafi –
   a. Një inxhinier te shkencave kompjuterike
   b. Një inxhinier te elektronikës apo te telekomunikacionit
5. OE duhet të ofroj Broshurat për produktet e ofruara

Dëshmia e dokumentuar:

1. Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit (2013, 2014, 2015) për furnizime - shërbime te ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve në 3 vitet (se paku dy referenca apo certifikata te pranimeve) duke saktësuar:
   a. punët e përfshira,
   b. shumën e kontratës,
   c. datën dhe pranuesin.
2. Autorizim nga prodhuesi për shitjen dhe servisimin e tyre.
3. Kopje te certifikatës te cilësisë se produkteve
4. Stafi te dëshmohet me kopje te diplomave dhe me kontrata për marrëdhënie pune
5. Broshurat apo katalogët për produktet e ofruara

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	DLD Group	Prishtinë	44,289.36 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 10.01.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë një (1) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 306)

Eksperti shqyrtues - teknik, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1

Autoriteti Kontraktues - "Komuna Prishtinë", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: **"PBC"shpk,** ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron se prashtruesi i ankeses OE "PBC"shpk, me datën 04.01.2017, ka paraqitur kërkesë per rishqyrtim pranë AK-së, përmes shkresës elektronike (e-mailit). Te njejten kërkesë i njejti OE edhe me datën 08.01.2017, e ka përseritur, me pretendimet ankimore se është bërë shkelje të nenit. 28 dhe 53, të LPP-së, si dhe nenit 18,dhe 22, të UOPP-së dhe neni 7, i rregullores per PP. AK – Komuna Prishtinë, sipas shkresave të lëndes nuk ka nxjerrur ndonjë Veprim kundër të njejtës kërkesë, veprimi i tillë paraqet mos respektim të nenit. **108/A**, të LPP-së, si dhe nenit 8, paragrafi 2, të rregullave për parashtrim të kërkesës, legjigjlacion i nxjerrur nga KRPP, ku shprehimisht thuhet " *Vendimi i AK-së është i deturueshëm për AK-në dhe duhet të zbatohet menjeherë. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe ti komunikohet me shkrim, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Në rast kur një zyrtar përgjëgjes i prokurimit nuk lëshon një vendim në lidhje me kërkesën për rishqyrtim, OE ka të drejtë të parashtroj ankesë në OSHP...".* AK, ka proceduar tutje duke bërë hapjen e ofertave – procesverbali i hapjes përmban datën 10.01.2017.

Poashtu sipas shkresave të lëndës AK- Kmuna Prishtinë, nuk i është përgjigjur kërkesave për sqarime shtesë, rrjedhimishtë veprimi i tillë paraqet mos respektim të nenit 53, paragrafi 4 të LPP-se, ku thuhet: *"Autoriteti kontraktues menjëherë do të shqyrtojë çfarëdo kërkese të tillë për të përcaktuar nëse operatorët ekonomik kanë apo nuk kanë nevojë për informatat sqaruese ose plotësues të kërkuar në mënyrë që të përgatisin një tender të përgjegjshëm".*

Pretendimet tjera ankimore lidhen me qështje teknike, konkretisht mos respektim të vendimit të OSHP-se, me nr 360, të dates 07.11.2016, të cilat janë shqyrtuar dhe trajtuar nga eksperti teknik si më poshtë:

Sqarimi 2. Lidhur me pretendimet ankimore për specifikime teknike, ekspertit teknik pas shqyrtimit të dosjes të ndryshuar nga autoritetit kontraktues, pas vendimit të OSHP-se me nr. 360, i datës 07.11.2016, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik ankues, sqaron se AK, sipas vendimit të lartë përmendura ka ndryshuar duke respektuar të njejtin vendim, rrjedhimishtë ka bërë ndryshimet dhe atë si më poshtë:

Kërkrkesat paraprake: "eKYC - electronic Knoë Your Customer", "Motor Magnet strip Reader, Smart dhe RFID Cerd Reader/Ëriter", dhe "AK e mban të drejtën që të kërkoj nga OE dhe prezantimin LIVE të funksionalitetit të aparatit nëse kërkohet nga AK, Prandaj nuk është obligative, përveç kërkohet nga AK. Referuar kërkesë se dosjes së tenderit, Specifikimet Teknike, me saktë (OE obligohet qe para vlerësimit te ofertave të prezantojnë pajisjen dhe funksionimin e tij në lokalet e komunës së Prishtinës)". Dosja e perpunuar nuk i përmban të njejtat kërkesa.

Kerkesa tjetër "Skeneri i shenjave te gishtit - Fingerprint Scanner", është lënë opsionale për ofertë

Poashtu kërkesa "Printeri Laserik, me kapacitet prej 40 faqe në minutë dhe Duplex (që printon në të dy anët, 1.b", dhe " dizajn modular metalik nga çeliku 1.5mm Anti-Vandal Kabine", janë modifikuar, rrjedhimishtë është respektuar vendimi i lartëpërmendur i OSHP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues - teknik:

Ekspertët e OSHP-së, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozon panelit shqyrtues qe procedura e prokurimit me titull: "**Furnizim me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve te gjendjes civile – E Kiosk**", me nr. të Prokurimit: **616 16 144 121**, të ANULOHET, dhe të ri-tenderohet nëse AK, ka ende interes për të, ndërsa ankesa e OE "PBC", shpk **të aprovohet si pjesërisht e bazuar.**